



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr. Regj. 45819/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Ukë Rugova nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 par. 1 i ndëshkuar sipas nenit 16 par. 1.3 te Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë peronat Zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.l.pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 11.10.2013 merr këtë

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtës ndaj Ukë Ibrahim Rugova i lindur me 03.06.1980 ne Prishtinë, ku dhe tani jeton në rrugën Hamdi Gashi nr. 24, për kundërvajtje nga 8 par. 1 i ndëshkuar sipas nenit 16 par. 1.3 te Ligjit nr. 04/L-050 per Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë peronat Zyrtar.

Konform neni 198 al.l pik. 8 te LMK-es Pezullohet Procedura ,pasi qe nuk ka provë se ka kryer kundërvajtje. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës

Ar sy e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr. 01-5029/2011 të dt.27.12.2011, për zhvillimin e procedurës kundërvajtës kundër të lartpërmendurit e për kundërvajtjen e lartcekur, duke propozuar të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit. Gjyqtari në shkallë të parë, me dt. 31.08.2012, ka marrë aktvendim me të cilin Pezullon lëndën ne mungesë te provavbe. Kundër këtij aktvendimi Agjensioni kundër korrupsionit, ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Lartë për kundërvajtje. Gjykata e Lartë me aktvendimin GJL. nr. 1086/2012 dt. 18.10.2012, ka aprovuar ankesën e agjencionit si të bazuar, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e ka abroguar, që të merren edhe këto veprime: të dëgjohet dorëzuesi i postes i cili duhet te dëshmoj se a ja ka derzuar te pandehurit ftesën e AKK-së e cila ka qenë e adresuar ne emër të tij apo dikujt tjetër.

Duke vepruar sipas konstatimeve dhe vërejtjeve të theksuara më lartë u dëgjua parashtruesi i kerkeses Enis Sadiku i cili në deklaratën e tij pohoj se e pasi qe u njoftova me kërkesën dua te precizoj këto rrethana kohen e kryerjes se kundërvajtjes e cila i vihet ne barrë Ukë Rugovës ku shihet se kërkesa për plotësimin e formularit e cila është drejtuar deputetet Ukë Rugova ishte marr 23.11.2011 ku shihet se për plotësimin e njëjti ka 15 ditë sipas ligjit për ta përmbush dhe pas keti afati është 08.12.2011 si data e kryerjes se kundërvajtjes e cila është e përcaktuar te pasurisë kemi gjetur gabime me te cila nuk janë përputhur te dhënat tona në formularët e paraqitur dhe kemi kërkuar në bazë të kërkesës se ky nuk e kishte deklaruar biznesin me emër 08 paragrafi SHPK e që i kemi dhanë afat ligjor 15 ditë qe ta plotësoj ketë formular, i cili i ndëshkuar sipas neni 1.5

Ne deklaratën e dhanë të dorëzuesit të PTK-së Fejzullah Spahiu i cili deklaroi se, pasi qe u njoftova me kërkesën dhe për natyrën e qeshtjes mund te deklaroi se unë në cilësinë e dorëzuesit ku punoj në posten nr. 6 dhe bej shpërndarjen e te gjitha shkresave nëpër shumë vende po ashtu edhe në Kuvendin e R. Se Kosovës dhe me datën 23.11.2011 e kam derzuar posten dhe për shumë persona tjerë po ashtu edhe për personin Ukë Rugova ku është edhe në librin e dozimit i cili ka qenë në renditje 5 emri i Ukë Rugovës për ketë unë sa i përket mënyrës se dozimit unë e dërgoj në sportelin në hyrjen kryesore te Kuvendit dhe nga unë e pranon një person, atë ditë me sa me kujtohet a ka pranuar një peron me emirin Lumë por nuk jam i sigurt se a është kjo në qofse e siguroj emrin dhe mbiemrin do të njoftoj gjyqtarin se si është emri i vërtet i saj dhe si vepron ajomë shpërndarjen e dërgesave unë nuk e dinë veprimë çdo herë kështu.

Po ashtu u ftua edhe personi përgjegjës SH.P. Arshivës së Kuvendit te Kosovës, ku kësaj ftese i përgjigjur ftesës Shefqet Hasimi i cili pohoj se pasi qe u njoftova me kërkesën unë jam zyrtar ligjor në Ministrin e drejtësisë ku e bëje përfaqësimin e Ministrisë se Drejtësisë si dhe te Kuvendi, sipas autorizimeve por në rastin konkret nuk kam te bëjë me përfaqësim, por kanë te bëjë me dëshmi te personave konkret, kështu qe sa i përket dëshmisë se personi konkret a e ka pranuar apo nuk është pranuar unë nuk mund te deklaroi se nuk i njohe këto rrethana

